

## PROCES VERBAL

### 1. Specifikime Teknike

OBJEKTI: : “Shërbime mirëmbajtje ndërtimor për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Fondi Limit: 3,536,323.68 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kontraktori është i detyruar të zbatojë normat teknike, sipas manualeve të ndërtimit.

Të gjithë materialet që do të përdoren duhet të jenë të cilësisë së parë.

Të gjitha pajisjet që do të përdoren duhet të jenë cilësore dhe të shoqërohen me certifikatën e cilësisë/ skedën teknike të prodhuesit.

Specifikime teknike për zerat e preventivit, mbështeten në manuale të teknike të ndërtimit.

- **Shtrese parketi laminat**

Mund të jetë i nevojshëm riparimi në zyrat egzistuese, ose shtrimi me parket laminant. Në çdo rast do të kërkohej parket cilësor, në përputhje me ngjyrat dhe format e atij egzistues në rastin e riparimeve.

- **Lyerja**

Lyerja do të jetë për ambientet e brendshme dhe të fasades me boje hidroplastike, cilësi e parë. Pergatitja e mureve për lyerje të bëhet sipas kërkesave teknike. Lyerja duhet të jetë në dy dyar.

- **Tubat e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm**

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave mund të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 ose mund të përdoren tuba xingato që janë konform standarteve të mësipërme për cilësinë dhe testimin e tyre.

- **Saraçineskat për ujin e pijshëm**

Saraçineskat duhet të jenë me material të kromuar.

- **Ulluk shkarkimi**

Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike PVC që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.

- **Rakorderitë për tubat e shkarkimit të ujrave**

Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren rakorderitë përkatëse me material plastik PVC, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.